UDHËZIM
Nr. 60, datë 9.5.2022

PËR PËRBËRJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONEVE TË VLERËSIMIT TË GRADAVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3, të nenit 24, të ligjit nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin",

UDHËZOJ:

1. Ngritjen e Komisioneve të Vlerësimit të Gradave për strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në nivel qendror për punonjësit e nivelit të lartë, të mesëm, si dhe në nivel vendor për punonjësit e nivelit bazë.

2. Komisioni i Vlerësimit të Gradave për punonjësit e nivelin e lartë të strukturës së MZSH-së përbëhet nga:

a) Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit të MZSH-së, kryetar;

b) Drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së, anëtar;

c) Drejtor i Drejtorisë së Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, anëtar.

3. Komisioni i Vlerësimit të Gradave për punonjësit e nivelit të mesëm të strukturave të shërbimit të MZSH-së përbëhet nga:

a) Drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së; kryetar;

b) Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Miradministrimit dhe Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, anëtar;

c) Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të MZSH-së, anëtar.

4. Komisioni i Vlerësimit të Gradave për punonjësit e nivelit bazë të strukturave të shërbimit të MZSH-së në nivel vendor, përbëhet nga:

a) Drejtor/Shef sektori i Shërbimit të MZSH-së në Njësinë e Vetëqeverisjes Vendore, kryetar;

b) Specialist i burimeve njerëzorë në Njësinë e Vetëqeverisjes Vendore, anëtar;

c) Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të MZSH-së, anëtar.

5. Komisionet e Vlerësimit të Gradave funksionojnë si organ kolegjial vlerësues dhe propozues në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" për fitimin e gradës. Komisionet dërgojnë aktet e vlerësimit për punonjësit e MZSH-së tek autoritetet e përcaktuara në nenin 24 të ligjit vetëm nëse janë plotësuar kriteret:

a) të këtë përmbushur kriteret për pozicionin e punës;

b) të jetë parashkruar masa disiplinore për shkelje të rëndë, sipas afatit të përcaktuar në ligjin nr. 152/2015;

c) vlerësimi i aftësive individuale të punës të jetë jo më i ulët se 70% të vlerësimit të përgjithshëm;

ç) të ketë përfunduar trajnimin e detyrueshëm për gradë pranë Akademisë së Sigurisë.

d) të mos ketë filluar ndaj tij procedim penal;

dh) të mos ketë filluar ndaj tij procedim disiplinor për shkelje të rëndë;

e) të ketë plotësuar kohën e qëndrimit në gradë, sipas afateve të përcaktuara në nenin 25 të ligjit nr. 152/2015.

6. Komisionet e Vlerësimit të Gradave trajtojnë çdo kërkesë të punonjësve të shërbimit të MZSH-së, për vlerësimin e gradave, brenda 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës.

7. Komisionet e Vlerësimit të Gradave, në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, hartojnë aktin e vlerësimit, në përputhje me kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", dhe vendimit nr. 895, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".

8. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Gradave nuk mund të vlerësojnë dhe të trajtojnë një kërkesë nëse ekziston një nga shkaqet e parashikuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 "Mbi parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, dhe neneve 30 dhe 31, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në RSH".

9. Anëtari Komisionit të Vlerësimit të Gradave, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për një anëtar të komisionit njofton duke parashtruar arsyet për të cilat kërkohet zëvendësimi sipas funksionit, dhe në çdo rast nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni në rastet e kur ai vetë kërkon ose vlerësohet me gradë, sipas kritereve të nenet 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 895, datë 21.12.2016, "Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimit teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".

10. Ankimi i punonjësve të shërbimit të MZSH-së, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Gradave, trajtohet rast pas rasti, në përputhje me parashikimet e kreut II, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë".

11. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të MZSH-së, Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, si dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore që kanë strukturat përkatëse të këtij shërbimi.

12. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm të sigurojë zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi.

13. Udhëzimi nr. 211, datë 3.4.2017, "Për përbërjen dhe funksionimin e vlerësimit të gradave", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi